

<b>DHOMA E POSAÇME E GJYKATËS SUPREME TË KOSOVËS PËR ÇËSHTJE QË LIDHEN ME AGJENCINË KOSOVARE TË MIRËBESIMIT</b>	<b>SPECIAL CHAMBER OF THE SUPREME COURT OF KOSOVO ON KOSOVO TRUST AGENCY RELATED MATTERS</b>	<b>POSEBNA KOMORA VRHOVNOG SUDA KOSOVA ZA PITANJA KOJA SE ODNOSE NA KOSOVSKU POVERENIČKU AGENCIJU</b>
---	--	---

**ASC – 09 – 0083**

Në padinë e

*Paditësi/Ankuesi*

**Ndërmarrja Shoqërore** [REDACTED]

[REDACTED] Prishtinë

e përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit  
Ilir Konushevcu 8, Prishtinë

kundër

*I Padituri*

[REDACTED] **Ndërmarrje Tregtare**

E përfaqësuar nga [REDACTED], avokat në Prishtinë  
[REDACTED]

Kolegji i Ankesave i Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Mirëbesimit (DHPGJS), i përbërë nga Richard Winkelhofer, Kryetar i DHPGJS-së, si Gjyqtar Kryesues, Torsten Frank Koschinka dhe Ejia-Liisa Helin, Gjyqtarë, në ankesën e Paditësit kundër aktvendimit të DHPGJS-së të datës 29 tetor 2009, SCC-09-0154, (të bashkuar me shkallën e parë me SCC-09-0133) më 4 shkurt 2010 lëshon këtë:

### **AKTVENDIM**

**Ankesa hedhet poshtë si e papranueshme.**

#### **Rrethanat Faktike dhe Procedurale:**

Më 7 gusht 2009, Paditësi parashtrori padi (SCC-09-0154) në DHPGJS në mënyrë që të urdhërojë të Paditurin të ndalojë çfarëdo veprimi për të ndryshuar statusin e fundit të posedimit faktik në lidhje me pasurinë e paluajtshme të regjistruar si ngastra kadastrale nr. 7155/1 dhe 7154/1 të cilat gjenden në 'Rruga Hekurudha' nr. 24-26 në Prishtinë. Në të njëjtën ditë, Paditësi parashtrori një kërkesë për

## II

lëshimin e masave të përkohshme të sigurisë mbi ndalimin e regjistrimit dhe tjetërsimin e pasurisë së paluajtshme. Më 10 gusht 2009, Paditësi parashtrroi një kërkesë (SCC-09-0154) për lëshimin e ndalimit të përkohshëm duke pohuar se i Padituri ka filluar të shkatërrojë dhe dëmtojë ndërtesat që gjenden në ngastrat kadastrale të lartpërmendura.

Më 14 gusht 2009, Trupi Gjykses i DHPGJS-së e lëshoi një aktvendim (SCC-09-0154) duke e urdhëruar të Paditurin të ndalojë çfarëdo veprimi në lidhje me ngastrat e cekura më lartë numër 7155/1 dhe 7154/1 në Prishtinë, i cili do të mund të shpie në ndryshimin e statusit faktik të këtyre ngastrave, dhe të përmbahet nga ndërmarrja e çfarëdo veprimi mbi ngastrat e përmendura, veçanërisht por jo në mënyrë ekskluzive të përmbahet në dëmtimin dhe shkatërrimin e ndërtimeve. Në bazë të aktvendimit, ndalimi i përkohshëm do të mbetet në fuqi derisa të merret vendimi i prerë mbi meritat nga DHPGJS-ja. I Padituri është ankuar kundër aktvendimit të lartpërmendur. Kolegji i Ankesave ka refuzuar ankesën me aktvendimin e tij të marrë më 4 shkurt 2010 (ASC-09-0053).

Më 29 tetor 2009, Trupi Gjykses lëshoi një aktvendim (SCC-09-0154) me anë të të cilit kërkesa e Paditësit e datës 7 gusht 2009 për lëshimin e ndalimit të përkohshëm ishte hedhur poshtë si e papranueshme. Sipas aktvendimit, kërkesa për ndalimin e përkohshëm duhet të ketë të njëjtin objekt si padia kryesore bashkë me të cilën është parashtruar, ndërsa në këtë rast kjo qartë e kishte një objekt tjetër. Aktvendimi vazhdon duke theksuar se Agjencia Kosovare e Privatizimit nuk ka dorëzuar padi në lidhje me të drejtat pronësore të cilat përfshihen me kërkesën për ndalim të përkohshëm. Për më tepër, aktvendimi i Trupit Gjykses thotë se në lëndën SCC-09-0154 veç është lëshuar një ndalim i përkohshëm në lidhje me padinë për posedim.

Më 16 nëntor 2009, Paditësi/Ankuesi ushtroi ankesë kundër aktvendimit të cekur më lartë të Trupit Gjykses me datën 29 tetor 2009. Në ankesën e tij Paditësi/Ankuesi kërkon nga Kolegji i Ankesave që të anulojë aktvendimin dhe të vërtetojë aktvendimin e Trupit Gjykses të datës 14 gusht 2009, me anën e të cilit u lëshua ndalimi i përkohshëm. Edhe vet Paditësi/Ankuesi është i mendimit se Trupi Gjykses tanimë ka vendosur për të njëjtën çështje me aktvendimin e mëparshëm. Për më tepër, Paditësi/Ankuesi pohon se është ushtruar ankesë

### III

ndaj aktvendimit të mëhershëm të Trupit Gjykses të datës 14 gusht 2009 i cili bëri ndalimin e përkohshëm.

#### **Arsyetimi Ligjor:**

##### *Përfaqësimi i Paditësit*

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) e themeluar në nëntor të vitit 2002 nga Rreg e UNMIK-ut 2002/13, e ndryshuar me Rreg e UNMIK-ut 2005/18, e pushoi operimin e saj në qershor të vitin 2008. Aktivitet e saj, përfshirë edhe përfaqësimin e ndërmarrjeve shoqërore (NSH-ve) pran Gjykatës Supreme, faktikisht u morën përsipër nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP).

Duke e marrë parasysh gjendjen faktike në teren në Kosovë me AKM-në e cila tanimë nuk po i ushtron detyrat dhe përgjegjësitë e veta sipas Rreg të UNMIK-ut 2002/13, me ndryshim, dhe duke e pas parasysh se është nevojë e menjëhershme që NSH-të të përfaqësohen si duhet pran Dhomës së Posaçme, dhe duke e marrë në konsiderim se si parim themelor sistemet ligjore që e respektojnë sundimin e ligjit nuk lejojnë vakume ligjore, përfaqësimi i NSH-ve nga AKP-ja tani për tani do të pranohet.

Prandaj, Paditësi konsiderohet si i përfaqësuar në mënyrë të duhur nga AKP-ja.

##### *E drejta për tu ankuar.*

Në bazë të nenit 4.4 të Rregullores së UNMIK-ut (Rreg) 2008/4 Kolegji i Ankesave do të ketë juridiksion ekskluziv për të vendosur mbi ankesat ndaj çdo aktvendimi ose vendimi të Trupit Gjykses të Dhomës së Posaçme, përveç nëse me këtë Rregullore parashihet ndryshe. Neni 55.5 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut (UA) 2008/6 përcakton se nëse Trupi Gjykses e lëshon një aktvendim i cili mundëson masë të përkohshme, mund të parashtrahet ankese ndaj atij aktvendimi.

Rregullorja e UNMIK-ut 2008/4 nuk parasheh ndonjë kufizim ndaj të drejtës për tu ankuar, nëse nuk lëshohet një ndalim i përkohshëm. Prandaj, në pajtim me nenin 4.4 të Rregullores së UNMIK-ut 2008/4, Kolegji i Ankesave konsideron se

#### IV

edhe ndaj aktvendimeve të Trupit Gjykses, në të cilat nuk lëshohet ndalimi i përkohshëm, mund të ushtrohet ankesë.

*Mungesa e interesit ligjor për tu ankuar.*

Ankesa është e papranueshme në bazë të asaj se Paditësit/Ankuesit i mungon interesi ligjor në këtë çështje.

Trupi Gjykses sot vendosi në lëndën me numër ASC-09-0053 (Paditësi: Ndërmarrje Shoqërore [REDACTED] i Padituri/Ankuesi: [REDACTED]) që të hedhë poshtë ankesën e të Paditurit kundër aktvendimit të Trupit Gjykses të datës 14 gusht 2009, SCC-09-0154. Me anën e atij aktvendimi Paditësit/Ankuesit i është lëshuar ndalim i përkohshëm kundër të Paditurit, në bazë të kërkesës së tij më datën 10 gusht 2009, dhe e ndërlidhë atë me padinë e tij të ushtuar më 7 gusht 2009.

Në ankesën e tij në këtë lëndë, Paditësi/Ankuesi në mënyrë të qartë paraqet se nuk sheh fare hapësirë për të pranuar kërkesën e tyre për një ndalim të dytë të përkohshëm, nëse aktvendimi i parë – siç është vërtetuar sot nga Kolegji i Ankesave, ASC-09-53 – mbetet ashtu. Prandaj, nuk ka më interes ligjor në anën e Ankuesit që të kontestoj aktvendimin e apeluar. Ankesa vetëm kundër arsyetimit ligjor të aktvendimit apo aktgjykimit të gjykatës nuk lejohet, pasi që vet arsyetimi ligjor nuk përmban ankesë për palët.

Richard Winkelhofer, Gjyqtar Kryesues

EULEX

(nënshkrimi)

Torsten Frank Koschinka, Gjyqtar

EULEX

(nënshkrimi)

Ejia-Lisa Helin, Gjyqtare

EULEX

(nënshkrimi)

Tobias Lapke, Regjistruer

EULEX

(nënshkrimi)